

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE**  
**Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**“DENI-D”SHPK**

**Sot me date 02 SHTATOR 2025, ne Shkoder,**

- Denisa Pashuku, shtetase shqiptare, lindur me 06.07.2002, ne Shkoder, Shqiperi, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. Personal K25706025M, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Vendosa te nenshkruaj kete Statut te meposhtem per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar , aktiviteti i se ciles te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i meposhtem.

**Neni 1**  
**Emri i Shoqerise dhe Forma Ligjore**

- 1.1 Ne baze e ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, themelohet Shoqeria “**DENI-D**” SHPK e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi “SHPK” e cila perfaqeson formen juridike te saj, te ciles ketej e tutje do ti referohemi si “Shoqeria”.
- 1.2 Shoqeria eshte nje person juridik Shqiptar, qe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008” Per Tregtaret dhe Shoqeri Tregtare” (Ligji per Shoqerite“).
- 1.3 Shoqeria fiton personalitetin juridik nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (“QKB”), ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 1.4 Ortaket e Shoqerise gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne kufirin e kontributeve perkatese te tyre ne kapitalin e perfaqesuar ne kuota.
- 1.5 Ne cdo dokument, fatura, shpallje apo publikime te bera nga Shoqeria , pamvarsisht nga menyra e transmetimit, emri i Shoqerise duhet te shoqerohet ose te ndiqet nga:
  - a. Fjalet “Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ose “SHPK”
  - b. Numri unik i identifikimit (NIPT):
  - c. Seline e regjistruar dhe zyren qendrore: dhe
  - d. Te dhena nese Shoqeria eshte ne proces likuidimi.

## **Neni 2**

### **Selia**

Ne momentin e miratimit te ketij Statuti , Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Paloke Kurti, Bulevardi Skenderbeu, Shkoder, godine 8-kateshe, kati 4, Zona kadastrale 8593. Shoqeria me vendim te Asamblese se Pergjithshme mund te zhvendose seline e saj ose te krijojte nje qender operative ne nje vend tjeter ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi ne cdo vend brenda ose jashte Republikes se Shqiperise, sipas gjykimit te Asamblese se Pergjithshme.

## **Neni 3**

### **3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte:**

Blerje dhe shitje me shumice dhe pakice te mishit te pulës, te pjeseve te tyre por edhe produkteve te tjera te te gjitha kafsheve, Import dhe eksport i produkteve te mishit, Furnizimi dhe tregtimi ne pikat e konsumit dhe tregjet e vendit te te gjitha produkteve qe permenden ne objektin e veprimtarise se Shoqerise, Blerje dhe shitje te artikujve te ndryshem,

## **Neni 4**

### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë per nje afat te pacaktuar, por gjithsesi mbi 10 vjet

## **Neni 5**

### **Ortakët**

Ne momentin e miratimit te ketij statuti ortakët te Shoqerise jane Denisa Pashuku me 100 % te vleres se kapitalit.

## **Neni 6**

### **Kapitali i Regjistruar**

#### **Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar**

6.1 Kapitali i shoqërisë është 100 000 leke, i ndare ne 1 kuote dhe eshte plotesisht i nenshkruar dhe i shlyer.

6.2 Kuota eshte e pjestueshme, e transferueshme , e trashgueshme ne perputhje me

legjislacionin Shqiptar. Ajo transferohet ne perputhje me Ligjin per shoqerite dhe regjistrohet ne Qendren Kombetare te Biznesit si dhe ne Librin e Ortakeve.

## **Neni 7**

### **Lenia dhe transferimi i pjeseve te kapitalit**

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek persona te trete, ne qofte se ortaku i vetem vendos per kete. Ai mund te lihet peng sipas legjislacionit ne fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem ne rruge trashegimie. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te behet me akt noterial.

## **Neni 8**

### **Struktura, organet drejtuese dhe administrimi i shoqerise**

#### **Ortaket**

Si organ i vetem administrues, drejtues dhe perfaqesues i shoqerise, sipas kerkesave ligjore, eshte asambleja e ortakeve

#### **Kompetencat e ortakut te vetem te shoqerise**

Kompetencat e ortakut te vetem do te jene:

1. Realizon administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me personat e tjere juridike ose fizike.
2. Vendos per ndryshimet ne statutin e shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per shoqerine apo per sektore te vecante te veprimtarise
3. Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per Shoqerine apo per sektore te vecante te veprimtarise
4. Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj
5. Emeton dhe shkarkon administratorin/et e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne statut
6. Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit si dhe shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
7. Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit
8. Shqyrton bilancin vjetor, percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e

- tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos per marrjen e kredive
9. Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizike ose juridike
  10. Vendos per mbarimin e shoqerise, likujdimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera
  11. Realizon maredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere juridike apo fizike, vendas apo te huaj
  12. Vendos cmimet e shitjes, te sherbimeve etj
  13. Vendos per pagat e te punesuarve ne shoqeri etj

## **Neni 9**

### **Administratorët**

#### **Emërimi i Administratorëve**

Zgjidhet si administrator i vetem i shoqerise znj. Denisa Pashuku per nje periudhe 5 vjecare Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Ortakut te Vetem sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Ortaku i Vetem dhe udhëzimet e Ortakut te Vetem nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

#### **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa arsye

## **Neni 10**

### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Dividendët**

- (1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumatat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Ortaku, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

## **Neni 11**

### **Bilanci**

Bilanci mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel autorizuar nga ortaku i vetëm miratohen nga vetë ortaku i vetëm.

## **Neni 12**

### **Prishja dhe njoftimet**

#### **Mbarimi**

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsye të parashikuara në ligj.

#### **Likuidimi**

Shoqëria hyn në proces likuidimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku i Vetëm cakton një ose më shumë likuidatore, të cilit i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe nevojshëm të perfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Pas pagimit të kreditorëve, Ortaku i vetëm mban pjesën

e mbetur te kapitalit

### **Neni 13**

#### **Dispozita te fundit**

Te gjitha mosmarrevshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente shqiptare Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e te ciles do te percaktohen nga ortaku i vetem.

### **ORTAKET**

**Denisa Pashuku**

